



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 4 /2017 PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS
SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

**ADMINISTRATIVNA UREDBA BR. 4 /2017 O PROCENI PERFORMANSE
OBRAZOVNIH INSTITUCIJA U PREDUNIVERZITETSKOM OBRAZOVANJU**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 4 /2017 FOR EVALUATION OF THE
EDUCATIONAL INSTITUTIONS PERFORMANCE IN PRE-UNIVERSITY
EDUCATION**

<p>Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (<i>Gazeta zyrtare nr 82, 21 tetor 2010</i>), nenit 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (<i>22 mars 2011</i>), si dhe duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nxjerr:</p>	<p>Ministar obrazovanja, nauke i tehnologije, Na osnovu člana 4.21.22. Zakona br. 03/L-189 o državnoj upravi Republike Kosova (<i>Službeni glasnik br. 82, 21 oktobar 2010</i>), član 8 (1.4) i prilog 6 Pravilnika br. 02/2011 za oblast administrativne odgovornosti Kancelariji premijera i ministarstva (<i>22 marta 2011</i>), kao i na osnovu član 5 Zakona br. 04/L-032 o Preduniverzitetkom obrazovanju u Republici Kosova, donosi se:</p>	<p>Minister of Education, Science and Technology, Pursuant to articles 4, 21, 22 of the Law no. 03/L-189 for state administration of the Republic of Kosova (official gazette no. 82, October 21, 2010), in article 8 (1.4) and appendix 6 of the Regulation no. 02/2011 for fields of administrative responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries (22 March 2011), and based in article 5 of the Law no. 04/L-032 for Pre-university education in the Republic of Kosova, issues:</p>
<p style="text-align: center;">UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 4/2017 PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR</p>	<p style="text-align: center;">ADMINISTRATIVNA UREDBA BR. 4/2017 O PROCENI PERFORMANSE OBRAZOVNIH INSTITUCIJA U PREDUNIVERZITETSKOM OBRAZOVANJU</p>	<p style="text-align: center;">ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 4/2017 FOR EVALUATION OF THE EDUCATIONAL INSTITUTIONS PERFORMANCE IN PRE- UNIVERSITY EDUCATION</p>
<p>Numër: Datë:</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p>	<p>Broj: Datuma:</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p>	<p>Number: Date:</p> <p style="text-align: center;">Article 1 The purpose</p>
<p>Ky Udhëzim administrativ përcakton procedurat për vlerësim të performancës së institucioneve arsimore dhe rolin e bartëseve kryesor të këtij procesi.</p>	<p>Ova Administrativna uredba utvrđuje procedure o proceni performanse obrazovnih institucija i ulogu glavnih nosioca ovog procesa.</p>	<p>This Administrative instruction determines procedures for evaluation of the educational institutions performance and role of main bearers of this process.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 2 Përkufizimet / definicionet</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Definicije</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Definitions</p>
<p>1. Ekipi për vlerësim të brendshëm/vetëvlerësim – grup i zgjedhur nga institucioni i cili është përgjegjës të realizojë vlerësimin e brendshëm në institucion siç përshkruhet në këtë UA dhe në udhëzuesit përkatës për vlerësim të brendshëm.</p> <p>2. Ekipi për vlerësim të jashtëm – grup i formuar nga inspektorati i arsimit, me inspektor të arsimit dhe vlerësues të jashtëm të miratuar nga MASHT, i cili është përgjegjës të realizojë procesin e vlerësimit të jashtëm në institucionin arsimor, siç përshkruhet në këtë UA dhe në udhëzuesit përkatës për vlerësim të jashtëm. Ekipi udhëhiqet nga inspektori i arsimit.</p> <p>3. Fushat e cilësisë së institucionit arsimor janë segmentet kryesore të veprimtarisë së institucionit/shkollës që do të shërbejnë si pika referuese për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në Kosovë,</p>	<p>1. Ekipa za interno vrednovanje /samovrenovanje – izabrana grupa od strane institucije koja je odabrana da realizuje interno vrednovanje u instituciji kao što se opisuje u ovoj AU i u relevantnom uputstvu za interno vrednovanje.</p> <p>2. Ekipa za eksternu procenu – grupa formirana od inspektorata za obrazovanje, inspektorima za obrazovanje i eksterne ocenjivače odobreno od strane MONT-a, koja je odgovorna da realizuje proces eksternog vrednovanja u obrazovnim institucijama, kao što je opisano u ovoj AU i u relevantnom uputstvu za eksternu procenu. Ekipu rukovodi inspektora za obrazovanje</p> <p>3. Oblasti kvaliteta obrazovne institucije su glavni segmenti aktivnosti institucije/škole koji će služiti kao referentna tačka za procenu performanse obrazovnih institucija na Kosovu, obezbeđujući</p>	<p>1. The team for the internal evaluation/self-evaluation - the selected group by the institution which is responsible to carry out internal evaluation of the institution, as it is described in this AI and in relevant guidelines for internal evaluation.</p> <p>2. The team for the external evaluation– the group formed by the education inspectorate, with education inspectors and external evaluation approved by MEST, which is responsible to implement the external evaluation process at the educational institution, as it is described in this AI and in the relevant guidelines for external evaluation. The team is led by the education inspector.</p> <p>3. Fields of quality of the educational institutions are key segments of the institution's / school activity that will serve as reference point for evaluation of educational institutions performance in Kosova, by ensuring coherence between</p>

<p>duke siguruar koherencë në mes të procesit të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm të shkollës</p>	<p>koherentnost između procesa samovrednovanja i eksterno vrednovanja škole</p>	<p>self-evaluation and external school evaluation.</p>
<p>4. Institucioni arsimor – përfshin çdo institucion edukativ, arsimor dhe aftësues i cili ofron shërbime arsimore në nivelet KNSA 0-4. Udhëzimi administrativ për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar, iu referohet niveleve KSNA 0-3, në të cilat do të bëhet vlerësimi i performancës së institucioneve në bazë të procedurave të këtij UA.</p>	<p>4. Obrazovna institucija – obuhvata sve edukativno obrazovne i osposbljavajuće institucije koje pružaju usluge na nivou KMSO 0-4. Administrativna uredba o vrednovanju performanse obrazovnih institucija u preduniverzitetskom obrazovanju, odnosi se na nivoima KMSO 0-3, u kojima će se vršiti vrednovanje performanse institucija prema procedurama ove AU.</p>	<p>4. Educational institutions – includes every upbringing, education and training institution, which provides educational services in ISCED levels 0-4. Administrative instruction for evaluation of educational performance in pre-university education refers to ISCED levels 0-3, in which will be done evaluation of institutions performance based on the procedures of this AI.</p>
<p>5. Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së institucionit arsimor- është politikë arsimore që përcakton: (i) Kriteret e cilësisë së performancës së institucionit arsimor, (ii) Treguesit e performancës së institucionit arsimor, (iii) Nivelet e vlerësimit të performancës së institucionit arsimor dhe (iii) Shkallët e cilësisë së performancës së institucionit arsimor.</p>	<p>5. Okvir za obezbeđivanje kvaliteta performanse u obrazovnoj instituciji - je obrazovna politika koja utvrđuje: (i) Kriterijume kvaliteta performanse obrazovane institucije, (ii) Pokazatelji performanse obrazovne institucije (iii) Nivo vrednovanje performanse obrazovne institucije i (iv) Stepen kvaliteta performanse obrazovne institucije.</p>	<p>5. Framework for quality assurance of the educational institutions performance – is educational policy that determines: (i) Quality criteria of the educational institution's performance, (ii) indicators of educational institution's performance, (iii) evaluation levels of educational institution's performance and (iv) the quality degree of educational institution's performance.</p>

<p>6. Kriteret e cilësisë – përshkruajnë pritshmëritë themelore që duhet të përmbushen nga çdo shkollë që funksionon në Republikën e Kosovës. Janë nën-ndarje të fushave të cilësisë që shërbejnë për të siguruar qasje më sistematike gjatë mbledhjes së të dhënave dhe koherencë në mes të dy proceseve të vlerësimit (vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm).</p>	<p>6. Kriterijumi kualiteta – opisuje osnovna očekivanja koje mora da ispuniti svaka škola koja funkcioniše u Republici Kosovo. Oni su pod-podeli kvaliteta koje služe da se obezbedi sistematičan pristup u prikupljanju podataka i koherentnost između dva procesa procene (samoprocene i eksterne procene).</p>	<p>6. Quality criteria – describe basic expectations that need to be met from each school that functions in the Republic of Kosovo. Are sub-divisions of quality fields, which serve to ensure a more systematic approach during data collection and coherence between the two evaluation processes (self-evaluation and external evaluation).</p>
<p>7. Performanca e institucionit arsimor është tërësia e punës së institucionit arsimor që manifestohet përmes shkallës së arritjes së kriterëve të cilësisë së institucionit arsimor dhe e vlerësuar me procesin e vlerësimit.</p>	<p>7. Performansa obrazovne institucije je sveukupni rad obrazovne institucije koji se manifestuje kroz stepen ostvarivanja kriterijume kvaliteta obrazovne institucije i vrednovane procesom vrednovanja.</p>	<p>7. Performance of the educational institutions is entirety of educational institution's work that is manifested through degree of achievement of the quality criteria of the educational institution and evaluated with the evaluation process.</p>
<p>8. Plani zhvillimor i institucionit arsimor/shkollës është dokument pune i obligueshëm që përgatitet nga institucioni arsimor që bazohet në raportin e vetëvlerësimit dhe që përcakton prioritetet dhe objektivat për sigurimin e cilësisë së punës së institucionit arsimor në periudhën afatmesme.</p>	<p>8. Razvojni plan obrazovne/školske institucije je obavezujući radni dokument pripremljen od strane obrazovne institucije koji se zasniva na izveštaj samovrednovanja i koji određuje prioritete i objektivne za obezbeđivanje kvalitet rada obrazovne institucije u srednjeročnom periodu.</p>	<p>8. Development plan of the educational institution / school is an obligatory work document that is prepared by the educational institution and that is based in the self-evaluation report and that determines priorities and objectives for quality assurance of the educational institution's work in the mid-term period.</p>
<p>9. Plani vjetor i veprimt është dokument pune i obligueshëm që</p>	<p>9. Godišnji akcioni plan je obavezni radni dokument kojeg priprema</p>	<p>9. Annual action plan is an obligatory work document that is prepared from the</p>

<p>përgatitet nga institucioni arsimor që bazohet në raportin e vetëvlerësimit dhe që përcakton (a) ndryshimet të cilat duhet t'i bëjë shkolla me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të performancës së saj, (b) masat e nevojshme për realizimin e këtyre ndryshimeve, (c) kohën/afatin e zbatimit të këtyre masave dhe (d) personat përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara.</p>	<p>obrazovna institucija koji se zasniva na izveštaj samovrednovanja i koji utvrđuje (a) promene koje bi trebalo da učini škola u cilju poboljšanja i unapređenja svoje performanse, (b) potrebne mere za realizaciju ovih promena, (c) vreme/rok sprovođenja ovih mera i (d) odgovorna lica za sprovođenje utvrđenih mera.</p>	<p>educational institution that is based in the report of self-evaluation and that determines (a) changes which should be made by the school in order to improve and advance its performance, (b) necessary measures for realization of these changes, (c) time / deadline for implementation these measures and (d) responsible persons for implementation of specific measures.</p>
<p>10. Vlerësim i brendshëm/vetëvlerësim – kontrolli i planifikuar, sistematik i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga MASHT, i cili kryhet nga shkolla në intervale të rregullta, duke u bazuar në kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës siç përshkruhet në Kornizën e sigurimit të cilësisë.</p>	<p>10. Interno vrednovanje//samovrednovanje - sistematska planirana kontrola standarda u oblasti kvaliteta utvrđenog od strane MONT-a, koje sprovodi škola u redovnim intervalima, na osnovu kriterijume kvaliteta i pokazatelje performanse kao što se opisuje u Okviru za obezbeđivanje kvaliteta.</p>	<p>10. Internal evaluation/ self-evaluation – planned and systematic control of standards in the quality field set out by the MEST, which is performed from the school in regular intervals, being based in quality criteria and indicators performance, as it is described in the Framework for quality assurance.</p>
<p>11. Vlerësim i jashtëm i shkollës – kontrolli i planifikuar, sistematik i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga MASHT, i cili kryhet në intervale të rregullta nga inspektorët e arsimit në bazë të kriterëve të cilësisë dhe treguesve të performancës të përcaktuara me</p>	<p>11. Eksterno vrednovanje škole – sistematski planirana kontrola standarda u oblasti kvaliteta utvrđenog od strane MONT-a, koju obavljaju u redovnim intervalima inspektori u obrazovanju na osnovu kriterijume kvaliteta i pokazatelje performanse utvrđenim Okvirom za</p>	<p>11. External school evaluation- planned and systematic control of standards in the quality field set out by the MEST, which is performed from the school in regular intervals, being based in quality criteria and indicators performance, as it is described in the Framework for quality assurance.</p>

<p>Kornizën për sigurimin e cilësisë.</p> <p>12. Treguesit e performancës - janë deklarata afirmative të pritshmërive të performancës në kuadër të secilit kriter të cilësisë. Treguesit shërbejnë për të konstatuar nivelin e performancës së shkollës në raport me pritshmëritë. Ata janë referenca kryesore me rastin e vlerësimit të performancës së shkollës në kuadër të kriterëve përkatëse.</p> <p>13. Zhvillimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm në të cilin përfshihet i gjithë stafi i institucionit arsimor dhe bazohet në ciklin e cilësisë: Planifiko – Bëj – Kontrolllo – Vepro.</p>	<p>utvrđivanje kvaliteta.</p> <p>12. Pokazatelji performanse - su afirmativne izjave oćekivanja performanse u okviru svakog kriterijuma. Pokazatelji koriste se za konstataciju nivoa školske performanse u odnosu na oćekivanja. Oni su glavne preporuke prilikom vrednovanje školske performanse u okviru relevantnih kriterijuma.</p> <p>13. Razvoj kvaliteta je kontinuirani proces koji obuhvata kompletno osoblje obrazovne institucije i zasniva se na ciklus kvaliteta: Planiraj –Uradi –Kontroliši – Deluj.</p>	<p>12. Performance indicators – are affirmative statements of performance expectations within each criterion of quality. Indicators serve to ascertain the level of school performance compared with expectations. They are the main reference during the school performance evaluation within the relevant criteria.</p> <p>13. The quality development is a continuous process that includes the entire staff of the educational institution and is based on the quality cycle: Plan - Do - Check – Act.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Sistemi i vlerësimit të performancës së institucionit arsimor</p> <p>1. Sistemi i vlerësimit të performancës së institucionit arsimor përbëhet nga</p> <p>1.1 Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi i</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Sistem vrednovanje performanse obrazovne institucije</p> <p>1. Sistem vrednovanje performanse obrazovne institucije sastoji se od:</p> <p>1.1. Internog vrednovanja/samovrednovanje</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 The evaluation system of the educational institution performance</p> <p>1. System for performance evaluation of the educational institution is consisted of:</p> <p>1.1. Internal evaluation/ self-evaluation of educational institution; and</p>

<p>institucionit arsimor; dhe</p> <p>1.2 Vlerësimi i jashtëm.</p> <p>2. Qasja e sistemit për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në Kosovë është zhvillimore dhe i shërben planifikimit zhvillimor të institucionit arsimor dhe sigurimit të cilësisë së sistemit arsimor.</p> <p>3. Vlerësimi i performancës së institucionit arsimor konstaton gjendjen dhe trendin e performancës së institucionit arsimor</p>	<p>obrazovne institucije; i</p> <p>1.2. Eksterno vrednovanje.</p> <p>2. Pristup sistema vrednovanje performanse obrazovne institucije na Kosovu je razvojno i služi razvojnom planiranju obrazovnih institucija i obezbeđivanju kvaliteta u obrazovni sistem.</p> <p>3. Vrednovanje performanse obrazovne institucije konstatuje stanje i trend performanse obrazovne institucije</p>	<p>1.2. External evaluation.</p> <p>2. The system access for performance evaluation of educational institutions in Kosova is developmental and serves to the development planning of the educational institution and the quality assurance of the educational institution.</p> <p>3. The performance evaluation of the educational institution ascertains the condition and trend of performance of the educational institution.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4</p> <p style="text-align: center;">Parimet kryesore të vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore</p> <p>1. Pjesëmarrja: I gjithë personeli i institucionit arsimor kanë të drejtë dhe detyrë të marrin pjesë në vlerësimin e gjendjes dhe trendeve zhvillimore në institucion/shkollë, njëkohësisht, të gjithë do të jenë pjesë e planifikimit dhe zbatimit të masave përmirësuese në</p>	<p style="text-align: center;">Član 4</p> <p style="text-align: center;">Glavni principi vrednovanje performanse obrazovnih institucija</p> <p>1. Učešće: Kompletно osoblje obrazovne institucije imaju pravo i dužnost da učestvuju u proceni stanja razvojnih trendova u institucijama/školama, istovremeno, svi će biti deo planiranja i primene mera poboljšanja u instituciji/školi, u skladu sa nalazima procene.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4</p> <p style="text-align: center;">Main principles of the performance evaluation of the educational institution</p> <p>1. Participation: all personnel of educational institution are entitled and have a duty, to participate in assessing condition and development trends at the institution/school; at the same time, everyone will be part of the planning and implementation of remedial measures in the institution / school, in accordance with the</p>

<p>institucion/shkollë, në pajtim me gjetjet e vlerësimit.</p>		<p>evaluation findings.</p>
<p>2. Transparenca: I gjithë personeli i institucionit arsimor, nxënësit dhe prindërit do të jenë të informuar për procedurën dhe gjetjet e vlerësimit të performancës së institucionit arsimor.</p>	<p>2. Transparentnost: Čitavo osoblje obrazovne institucije, učenici i roditelji biće informisani o procedurama i nalazima proceni performanse obrazovne institucije.</p>	<p>2. Transparency: all personnel of educational institution, students and parents will be informed for the procedure and findings of the performance evaluation of the educational institution.</p>
<p>3. Objektiviteti: Vlerësim që siguron pasqyrë reale e të paanshme të performancës së institucionit arsimor.</p>	<p>3. Objektivnost: Vrednovanje koje obezbeđuje realan i nepristrasan pregled performanse obrazovne institucije.</p>	<p>3. Objectivity: evaluation that provides real and impartial mirror of performance of the educational institution.</p>
<p>4. Saktësia: Të dhënat dhe dëshmitë e mbledhura do të jenë të verifikueshme dhe të dokumentuara në mënyrë të qartë për të gjitha palët e interesuara në procesin e (vet) vlerësimit të performancës së institucionit arsimor.</p>	<p>4. Taçnost: Podaci i prikupljeni dokazi će biti verifikovani i dokazani na jasan način za sve zainteresovane stranke u procesu (samo) ocenjivanje performanse obrazovne institucije.</p>	<p>4. Accuracy: data and gathered evidences will be verified and documented clearly for all interested parties in the process of (self-) evaluation of the educational institution performance.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Nivelet e vlerësimit të performancës së institucionit arsimor</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Nivoi vrednovanje performanse obrazovne institucije</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Evaluation levels of the educational institution performance</p>
<p>1. Vlerësimi i institucionit arsimor/shkollës realizohet në tri nivele:</p>	<p>1. Vrednovanje obrazovne/školske institucije realizuju se na tri nivoa:</p>	<p>1. Evaluation of the educational institution / school is realized in three levels:</p>

<p>1.1. Në nivel të kritereve të cilësisë;</p> <p>1.2. Në nivel të fushave të cilësisë, dhe</p> <p>1.3. Në nivel të përgjithshëm të performancës.</p> <p>2. Fushat dhe kriteret e cilësisë janë të përcaktuara me Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së institucioneve arsimore.</p>	<p>1.1. Na nivou kriterijume kvaliteta;</p> <p>1.2. Na nivou oblasti kvaliteta, i</p> <p>1.3. Na opštem nivou performanse.</p> <p>2. Oblasti i kriterijumi kvaliteta utvrđeni su Okvirom za obezbeđivanje kvalitet performanse obrazovnih institucija.</p>	<p>1.1. In the quality criteria level</p> <p>1.2. In the quality fields level and</p> <p>1.3. In general performance level</p> <p>2. The quality fields and criteria are defined by the Framework for quality assurance of the educational institutions performance.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p style="text-align: center;">Shkallët e vlerësimit të performancës së institucionit arsimor</p>	<p style="text-align: center;">Član 6</p> <p style="text-align: center;">Stepen procene performanse obrazovne institucije</p>	<p style="text-align: center;">Article 6</p> <p style="text-align: center;">Evaluation degrees of the educational institution performance</p>
<p>1. Shkallët e vlerësimit të performancës së institucionit arsimor kategorizohen si më poshtë:</p> <p>1.1 Performancë e shkëlqyeshme;</p> <p>1.2 Performancë e mirë;</p> <p>1.3 Performancë e pranueshme;</p> <p>1.4 Performancë e papranueshme.</p> <p>2. Shkallët e vlerësimit të performancës së institucionit arsimor janë të përshkruara në Kornizën për sigurim të cilësisë së</p>	<p>1. Stepeni procene performanse obrazovne institucije kategorisani su kao u nastavku:</p> <p>1.1. Odlična performansa;</p> <p>1.2. Dobra performansa;</p> <p>1.3. Prihvatljiva performansa;</p> <p>1.4. Ne prihvatljiva performansa.</p> <p>2. Stepe vrednovanje performanse obrazovne institucije je opisan u Okviru za obezbeđivanje kvaliteta u</p>	<p>1. The evaluation degrees of the educational institution performance are categorized as follows:</p> <p>1.1. Excellence performance</p> <p>1.2. Good performance</p> <p>1.3. Acceptable performance</p> <p>1.4. Unacceptable performance</p> <p>2. The evaluation degrees of the educational institution performance are described in the Framework for quality</p>

<p>institucioneve arsimore.</p>	<p>obrazovnim institucijama.</p>	<p>assurance of the educational institutions</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Fushat e cilësisë që janë objekt i vlerësimit të performancës së institucionit arsimor</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Oblasti kvaliteta koje su predmet vrednovanja performanse obrazovne institucije</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 The quality fields that are subject to evaluation of the performance of the educational institution</p>
<p>1. Në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së institucioneve arsimore përcaktohen pesë fusha të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Menaxhimi dhe qeverisja; ▪ Kultura dhe mjedisi shkollor; ▪ Mësimdhënia dhe nxënia; ▪ Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, dhe ▪ Performanca e nxënësve. 	<p>1. U Okvir za obezbeđivanje kvaliteta performanse obrazovnih institucija određuju se pet oblasti kvaliteta:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Menadžiranje i upravljanje; ▪ Kultura i školska sredina; ▪ Nastava i učenje; ▪ Profesionalni razvoj nastavnika, i ▪ Performansa učenika 	<p>1. In the framework of quality assurance of educational institutions performance are defined five quality fields:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Management and governance, ▪ Culture and school environment; ▪ Teaching and learning, ▪ Teacher professional development and ▪ Student performance.
<p>2. Në vetëvlerësimin e parë të performancës së institucionit arsimor, objekt vlerësimi janë të gjitha fushat e cilësisë.</p>	<p>2. U prvom vrednovanju performanse obrazovne institucije, cilj vrednovanja su sve oblasti kvaliteta.</p>	<p>2. In the first self-evaluation of the educational institution performance, subject of evaluation are all fields of quality.</p>
<p>3. Në të gjitha vetëvlerësimet pasuese të performancës së institucionit arsimor, objekt vlerësimi janë së paku dy fusha</p>	<p>3. Sva naredna samovrednovanja performanse obrazovne institucije, objektivni procene su najmanje dve oblasti</p>	<p>3. In all subsequent self-evaluations of the educational institution performance, subject of evaluation are at least two quality areas,</p>

<p>të cilësisë të cilat duhet të mbulojnë temat me interes shtetëror dhe me interes të shkollës.</p>	<p>kvaliteta koje treba da pokrивaju teme od državnog interesa i interesa škole.</p>	<p>which must cover topics of national interest and with school interest</p>
<p>4. Njëra prej fushave të cilësisë përcaktohet me këtë Udhëzim Administrativ dhe tjetra përcaktohet nga vet institucioni arsimor:</p> <p>4.1. Fusha e cilësisë që duhet të jetë objekt i ç'do vetëvlerësimi është performanca e nxënësve;</p> <p>4.2. Fusha tjetër përcaktohet nga vet institucioni arsimor;</p> <p>4.3. Institucioni arsimor/shkolla mund të përcaktohet që vlerësimin ta bëjë në më shumë se dy fusha të cilësisë.</p>	<p>4. jedna koja se utvrđuje ovom Administrativnom uredbom i druga utvrđuje sama obrazovna institucija:</p> <p>4.1. Oblast kvaliteta koji treba da bude objekat svakog samovrednovanja je performansa učenika;</p> <p>4.2. Druge oblasti određuje sama obrazovna institucija;</p> <p>4.3. Institucija obrazovanja/škola može se opredeliti da vrednovanje izvrši u više od dve oblasti kvaliteta.</p>	<p>4. One of them is defined with this Administrative instruction and the other is defined from the educational institution itself.</p> <p>4.1. The quality field that should be subject of each self-evaluation is the Student performance.</p> <p>4.2. The other field is defined from the educational institution itself.</p> <p>4.3. The educational institution / school can be defined to make evaluation in more than two quality fields.</p>
<p>5. Në vlerësimin e parë të jashtëm të performancës së institucionit arsimor, objekt vlerësimi janë të gjitha fushat e cilësisë.</p>	<p>5. U prvom eksternom vrednovanju performanse obrazovne institucije, objektivni vrednovanja su sve kvalitetne oblasti</p>	<p>5. In the first external evaluation of the educational institution performance, all quality fields are subject of evaluation.</p>
<p>6. Në të gjitha vlerësimet e jashtme pasuese, performanca e institucionit arsimor vlerësohet në fushën e cilësisë performanca e nxënësve dhe në fushën/at e cilësisë të cilat kanë qenë</p>	<p>6. U svim narednim eksternim vrednovanjima, performansa obrazovne institucije se vrednuje iz oblasti kvaliteta performanse učenika i iz oblast/i kvaliteta koji su bili cilj poslednjeg</p>	<p>6. In all subsequent external evaluations, the educational institution performance is evaluated in the quality field Student performance and in the quality field which has been subject of the latest self-evaluation</p>

<p>objekt i vetëvlerësimit të fundit të institucionit arsimor.</p>	<p>samovrednovanja obrazovne institucije.</p>	<p>of the educational institution.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Bartësit e procesit të vlerësimit të performancës së institucionit arsimor</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; 2. Inspektorati i Arsimit; 3. Drejtoria Komunale e Arsimit; 4. Institucionet arsimore. 	<p style="text-align: center;">Član 8 Nosioci procesa vrednovanja performanse u obrazovnim institucijama</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije; 2. Inspektorat za obrazovanje; 3. Opštinski direktorijat za obrazovanje; 4. Obrazovne institucije. 	<p style="text-align: center;">Article 8 Providers of the evaluation process of the educational institution performance</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ministry of Education, Science and Technology, 2. Education inspectorate, 3. Municipal Education Directorate, 4. Educational institutions.
<p style="text-align: center;">Neni 9 Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Miraton të gjitha politikat arsimore dhe dokumentet tjera që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e performancës së institucionit arsimor. 	<p style="text-align: center;">Član 9 Zadaci i odgovornosti Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Usvaja sve obrazovne politike i druga dokumenta u vezi obezbeđivanje kvaliteta i vrednovanje performanse obrazovne institucije. 	<p style="text-align: center;">Article 9 Duties and responsibilities of the Ministry of Education, Science and Technology</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Approves all educational policies and other documents that are related with quality assurance and evaluation of the educational institution performance.

<p>2. Miraton planin për vlerësim të jashtëm të propozuar nga Inspektorati i Arsimit dhe koordinatori për sigurimin e cilësisë në MASHT.</p>	<p>2. Usvaja plan za eksterno vrednovanje predložen od strane Inspektorat za obrazovanje i koordinatora za obezbeđivanje kvaliteta u MONT.</p>	<p>2. Approves the plan for external evaluation, proposed by the Education Inspectorate and Coordinator for quality assurance in MEST.</p>
<p>3. Miraton listën e vlerësuesve të jashtëm/ekspertëve të jashtëm të propozuar nga Inspektorati i Arsimit për realizimin e planit njëvjeçar për vlerësim të jashtëm.</p>	<p>3. Usvaja listu eksternih ocenjivača/eksperata iz vani predloženih od strane Inspektorata za obrazovanje za realizaciju jednogodišnjeg plana za eksternu procenu.</p>	<p>3. Approves the list of external evaluators / external experts, proposed by the Education Inspectorate for implementation of one-year plan for external evaluation.</p>
<p>4. Analizon raportet e vlerësimit të jashtëm të performancës së institucioneve arsimore dhe i shfrytëzon ato për rishikim dhe zhvillim të politikave të reja arsimore.</p>	<p>4. Analiziraj izveštaje eksterne evaluacije performanse obrazovne institucije i iste upotrebljava za reviziju i razvoj nove obrazovne politike.</p>	<p>4. Analyses the external evaluation reports of the educational institution performance and uses them for review and development of new educational policies.</p>
<p>5. Ndërmerrë masa urgjente për përmirësim të gjendjes në institucionet arsimore, në bazë të rekomandimeve për MASHT-in nga Inspektorati i arsimit.</p>	<p>5. Preduzima hitne mere za poboljšanje situacije u obrazovnim institucijama, na osnovu preporuke MONT-a od strane Inspektorata za obrazovanje.</p>	<p>5. Undertakes urgent measures for improvement of condition in educational institution, based on recommendation of the education inspectorate for MEST.</p>
<p>6. Mbikëqyrë cilësinë e funksionimit të sistemit të vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore dhe siguron përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të këtij sistemi.</p>	<p>6. Nadgleda kvalitet funkcionisanja sistema proceni performanse obrazovnih institucija i obezbeđuje poboljšanje i kontinuirani napredak ovog sistema.</p>	<p>6. Monitors the quality of the educational institutions performance evaluation system functioning and provides improvement and continuous advancement of this system.</p>
<p>7. Angazhon një institut apo agjenci në sektorin e arsimit, për ofrimin e</p>	<p>7. Angažuje institut ili neku agenciju iz sektor obrazovanja, za pružanje</p>	<p>7. Hires an institution or agency in the education sector, to provide professional</p>

<p>mbështetjes profesionale për institucionet e përfshira në sistemin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore. Varësisht nga delegimi i përgjegjësisë, instituti/ agjencia i/e autorizuar:</p> <p>7.1. Përgatit udhëzues për vetëvlerësim të institucionit arsimor, udhëzues për vlerësim të jashtëm të performancës, programin e trajnimit për vetëvlerësim dhe vlerësim të jashtëm të institucionit arsimor.</p> <p>7.2. Ofron programe trajnimi për ekipet për vetëvlerësim dhe vlerësim të jashtëm të institucionit arsimor.</p> <p>7.3. Realizon studime për cilësinë e zbatimit të sistemit të vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore.</p>	<p>profesionalne podrške institucijama obuhvaćene u sistem vrednovanja performanse obrazovnih institucija. U zavisnosti od delegiranja odgovornosti, ovlaštenih instituta/ agencija/e:</p> <p>7.1. Priprema uputstvo sa samovrednovanje obrazovne institucije, uputstvo za eksternu procenu performanse, programa obuke za eksterno samovrednovanje i vrednovanje obrazovnih institucija.</p> <p>7.2. Pruža programe obuke za ekipe za eksterno samovrednovanje i vrednovanje obrazovne institucije.</p> <p>7.3. Realizuje istraživanja o kvalitetu sprovođenje sistema za procenu performanse obrazovnih institucija.</p>	<p>support for institutions involved in the evaluation system of educational institutions performance. Depending on the delegation of responsibility, institute / authorized agency:</p> <p>7.1. Prepares guidelines for self-evaluation of the educational institution, guideline for external evaluation of performance, training program and external evaluation of the educational institution.</p> <p>7.2. Provides training programs for self-evaluation teams and external evaluation of the educational institution.</p> <p>7.3. Realizes studies on the implementation quality of educational institutions' performance evaluation system.</p>
<p align="center">Neni 10 Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Arsimit (IA)</p>	<p align="center">Član 10 Zadaci i odgovornosti Inspektorata za obrazovanje (IO)</p>	<p align="center">Article 10 Duties and responsibilities of the education inspectorate (EI)</p>
<p>1. Realizon vlerësimin e jashtëm të performancës së institucioneve arsimore në përputhje me</p>	<p>1. Realizuje eksternu procenu performanse obrazovne institucije u skladu sa zakonodavstvom na snazi.</p>	<p>1. Realizes external evaluation of the educational institutions performance in accordance with legislation in force.</p>

<p>legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Propozon listën e shkollave dhe planin njëvjeçar për vlerësim të jashtëm për miratim nga Sekretari i përgjithshëm në MASHT.</p> <p>3. Përzgjedh dhe propozon listën e vlerësuesve të jashtëm për realizimin e planit njëvjeçar për vlerësim të jashtëm, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 17 të këtij UA.</p> <p>4. Përgatit përshkrimin e detyrave të ekipit për vlerësim të jashtëm të performancës së institucionit arsimor, bazuar në Nenin 18 të këtij UA.</p> <p>5. Formon ekipet për vlerësim të jashtëm të performancës së institucioneve arsimore, sipas kriterëve të përcaktuara me nenet 15 dhe 16 të këtij UA.</p> <p>6. Vendos çdo vit në bashkëpunim me koordinatorin për sigurim të cilësisë në MASHT lidhur me temat me interes shtetëror të cilat bëhen pjesë e planifikimit të zhvillimit të cilësisë në nivel të institucioneve arsimore.</p>	<p>2. Predlaže listu škola i jednogodišnji plan za eksterno vrednovanje na usvajanje od strane Generalnog sekretara MONT-a</p> <p>3. Bira i predlaže listu eksternih ocenjivača za realizaciju jednogodišnjeg plana za eksternu procenu, prema kriterijumima utvrđenim u član 17 ove AU.</p> <p>4. Priprema opis zadataka ekipe za eksternu procenu performanse obrazovne institucije, na osnovu član 18 ove AU.</p> <p>5. Formira ekipe za eksternu procenu performanse obrazovne institucije, prema kriterijume utvrđenim u član 15 i 16 ove AU.</p> <p>6. Odlučuje svake godine u saradnji sa koordinatorom za obezbeđivanje kvaliteta u MONT u vezi teme od državnog interesa koje postaju deo planiranja za razvoj kvaliteta na nivo obrazovnih institucija.</p>	<p>2. Proposes the list of schools and one-year plan for external evaluation for approval by the General Secretary in MEST.</p> <p>3. Selects and proposes the list of external evaluators for realization of one-year plan for external evaluation, according to criteria set in Article 17 of this AI.</p> <p>4. Prepares job description of the teams for external evaluation of the educational institution performance, based in Article 18 of this AI.</p> <p>5. Forms the teams for external evaluation of the educational institution performance, according to criteria set with Articles 15 and 16 of this AI.</p> <p>6. Decides every year in cooperation with quality assurance coordinator at the MEST about topics of national interest, which become part of quality development planning at the level of educational institutions.</p>
---	---	--

<p>7. Informon me kohë të gjitha institucionet arsimore për temat me interes shtetëror që do të vlerësohen në kuadër të planifikimit të zhvillimit të cilësisë, procedurat dhe afatet kohore për realizimin e vlerësimit të jashtëm.</p> <p>8. Mbikëqyrë dhe koordinon punën e ekipeve të vlerësimit të jashtëm.</p> <p>9. Përgatit raporte të përgjithshme për MASHT.</p>	<p>7. Informiše na vreme sve obrazovne institucije za teme od državnog interesa koje će se ocenjivati u okviru planiranja i razvoj kvaliteta, procedure i vremenski rokovi za realizaciju eksterne procene .</p> <p>8. Nadgleda i koordinira rad ekipa za eksterne procene.</p> <p>9. Priprema opšte izveštaje za MONT.</p>	<p>7. Timely informs all educational institutions for topics of national interest that will be evaluation within the quality development planning, procedures and deadlines for realization of external evaluation.</p> <p>8. Monitors and coordinates the work of the external evaluation teams.</p> <p>9. Prepares general reports for the MEST.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale të Arsimit</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Zadaci i odgovornosti Opštinskog direktorijata za obrazovanje</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Duties and responsibilities of the Municipal Education Directorate</p>
<p>1. Siguron pajisjen e të gjitha institucioneve arsimore të komunës përkatëse me dokumentet që rregullojnë sistemin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore.</p> <p>2. Siguron realizimin e proceseve të vetëvlerësimit të institucioneve arsimore brenda afateve të përcaktuara me këtë UA.</p>	<p>1. Obezbeđuje opremu za sve obrazovne institucije u relevantnoj opštini sa dokumentima koja uređuju sistem proceni performanse obrazovnih institucija.</p> <p>2. Obezbeđuje realizaciju procesa samovrednovanja obrazovnih institucija unutar rokova utvrđenih ovom AU.</p>	<p>1. Provides equipment for all educational institutions of the relevant municipality with documents that adjust the evaluation system of the educational institutions performance.</p> <p>2. Provides realization of self-evaluation processes of the educational institutions within deadlines set with this AI.</p>

